

- 1) Regjistrimi i Nipt-it
- 2) Hyrja dhe dalja e mallrave në Doganë
- 3) Deklarimi në Doganë
- 4) Regjimi i tranzitit
- 5) Regjimi i magazinimit doganor
- 6) Regjimi i përpunimit aktiv
- 7) Përdorimi i veçantë përfundimtar (end-use)
- 8) Regjimi i lejimit të përkohshëm
- 9) Regjimi i përpunimit pasiv
- 10) Zonat e lira
- 11) Regjistrimi i Nipt-it
- 12) Regjistrimi i Nipt-it
- 13) Regjistrimi i Nipt-it

Regjistrimi i Niptit

Për kryerjen e Procedurave Doganore, çdo kompani duhet të regjistrojë më parë NIPT-in në sistemin "Asycuda Eëorld".

Për regjistrimin e NIPT-it, çdo kompani duhet të paraqesë këto dokumenta: Në rastet kur NIPT-i lëshohet nga QKR-ja

- një fotokopje të Çertifikatës së Personit të Tatueshëm
- një kopje të ekstraktit të regjistrimit në QKR

Shënim: Administratori i kompanisë mund të dergojë dokumentat e mësipërm për regjistrimin e NIPT-it dhe me email në adresat:

borxhi@dogana.gov.al

Në rastet kur NIPT-i lëshohet nga DPT

- Çertifikatën Originale ose fotokopje të noterizuar të Personit të Tatueshëm

Hyrja dhe dalja e mallrave në Doganë

Mallrat hyjnë/dalin në/nga territori doganor shqiptar nga/në një vend të huaj në rrugë:

Tokësore: Mallrat i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore që nga çasti i hyrjes në territorin shqiptar. Këto mallra duhet të dërgohen pa humbur kohë nga personi që i transporton ato:

a) në zyrën doganore të caktuar nga autoritetet doganore ose në cilindo vend tjetër të caktuar ose miratuar prej tyre; ose

b) në një zonë të lirë, nëse mallrat duhen të futen në atë zonë të lirë drejtpërsëdrejti me rruge ujore, ajrore ose tokësore.

Rrugë ajrore të përcaktuara nga autoritetet përgjegjëse për trafikun ndërkombëtar, dhe mund të ulen e të ngrihen nga aeroportet ndërkombëtare të miratuara për trafik ajror me vendet e huaja.

Mjetet lundruese, të cilat transportojnë mallra që hyjnë ose dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe që lundrojnë në zonën doganore kufitare në det, liqene e lumenj të lundrueshëm, duhet të kenë në bord manifestin e mallrave.

Hekurudhore, e cila lejohe vetëm nepërmjet Shoqërisë hekurudhore që pranon të fusë në territorin doganor mallra të shoqëruara me një dokument dorëzimi, dhe është organi përgjegjës për kryerjen e formaliteteve doganore përkatëse.

Baza ligjore:

Hyrja e mallrave:

a) Deklarimi përmbledhës i parambërritjes së mallrave

b) Mbërritja e mallrave

c) Magazinimi i përkohshëm i mallrave

d) Vendosja e mallrave në një regjim doganor

e) Çlirimi i mallrave

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 119 deri 160 dhe 169 deri 181.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 233 deri 329 dhe 349 deri 363.

Dalja e mallrave:

a) Formalitete para daljes së mallrave

b) Formalitete e daljes së mallrave

c) Eksporti dhe Ri-eksporti

d) Njoftimi ri-eksportit

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 236 deri 249.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 693 deri 718.

Deklarimi i mallrave në Doganë

Deklarimi në doganë është paraqitja e mallrave që hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë pranë autoriteteve doganore për të kryer procedurat sipas njërës nga mënyrat e deklarimit.

Përfaqësimi në doganë:

Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë të deklarojë mallrat në doganë nëpërmjet një përfaqësuesi.

1. Përfaqësimi mund të jetë:

a) Përfaqësim i drejtpërdrejtë: kur përfaqësuesi deklaron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

b) Përfaqësim i tërthortë: kur përfaqësuesi deklaron në emër të tij dhe për llogari të të përfaqësuarit.

2. Një përfaqësues doganor duhet të jetë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen kushtet nën të cilat një përfaqësues doganor mund të ofrojë shërbime në Republikën e Shqipërisë.

Baza ligjore:

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 24 deri 26.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 78 deri 88.

REGJIMI I TRANSITIT

Regjimi i transitit lejon lëvizjen nga një pikë në tjetrën, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të:

a) mallrave jo shqiptare, pa ia nënshtruar këto mallra detyrimeve të importit dhe detyrimeve të tjera ose masave të politikës tregtare.

b) mallrave shqiptare, të cilat u nënshtrohen masave për eksportimin e tyre drejt vendeve të tjera dhe për të cilat janë kryer formalitetet përkatëse doganore për eksport.

Lëvizja e mallrave në territorin doganor Shqiptar kryhet:

a) nën regjimin e transitit; ose

b) kur mbulohet nga një Carnet TIR (Konventa TIR) në qoftë se kjo lëvizje:

1. ka filluar ose duhet të përfundojë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

2. lidhet me dërgesa mallrash që duhen shkarkuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të cilat transportohen së bashku me mallra të destinuara të shkarkohen në një vend tjetër; ose

c) kur mbulohet nga një Carnet ATA (Konventa ATA) i përdorur si dokument tranziti; ose

d) me postë (përfshirë paket postare).

Regjimi i transitit në territorin doganor Shqiptar zbatohet pa rënë ndesh me dispozitat e veçanta të zbatueshme për lëvizjen e mallrave të vendosura nën një regjim doganor ekonomik.

Sistemi i përbashkët i transitit me Kosovën, i cili u mundëson tashmë bizneseve nisjen e një procedure tranziti në territorin e Shqipërisë apo të Kosovës mbylljen e transitit në vendin tjetër (Kosovë apo Shqipëri) duke shmangur kontrollet e panevojshme kufitare duke sjellë përshpejtim të theksuar të procedurës së kalimit të kufirit dhe uljes së kostos për bizneset e përfshira në këto transaksione, përfshirë dhe kompanitë transportuese.

Baza ligjore:

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 203 deri 209.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 566 deri 630.

REGJIMI I MAGAZINIMIT DOGANOR

Regjimi i magazinimit doganor lejon ruajtjen në një magazinë doganore: të mallrave jo shqiptare, pa iu nënshtruar detyrimeve të importit ose masave të politikës tregtare; dhe të mallrave shqiptare, kur dispozitat në fuqi që rregullojnë fusha të veçanta, parashikojnë që vendosja e tyre në magazinat doganore kërkon zbatimin e masave që normalisht lidhen me eksportin e këtyre mallrave.

Përdorimi i këtij regjimi mundësohet nëpërmjet lëshimit të autorizimit përkatës nga autoriteti doganor kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) për personat që ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen si duhet të operacioneve;

b) kur autoritetet doganore mund të mbikëqyrin e kontrollojnë regjimin.

Lista e dokumentave për aplikimin në pajisjen me autorizim:

1. Aplikimi për të përfituar regjimin e magazinimit doganor bëhet pranë degës doganore mbikqyrëse dhe duhet të përmbajë:

2. Kërkesën tip sipas aneksit 8, Shtojca C të VKM nr. 651, datë 10.11.2017.

3. Dëshmi penaliteti, vërtetim së nuk ka ndjekje penale, të administratorit apo drejtorit të përgjithshëm, vërtetim së shoqëria nuk është në proces likuidimi.

4. Planimetri të ambienteve të planifikuara për regjimin e magazinimit doganor të shoqëruara me foto për çdo plan si brenda ashtu edhe jashtë.

5. Aktin e kalibrimit të kontenierëve (depozita, sillosa, etj) në rastet kur do të depozitohen lëngje apo materiale rifuxho.

6. Aktin e pronësisë së këtyre ambienteve ose kontratën e qiramarrjes (me një afat që përputhet minimalisht me planifikimin ekonomik të shoqërisë).

7. Një raport ekonomik minimalisht 2 vjeçar që tregon nevojën ekonomike të shoqërisë për përdorimin e regjimit të magazinimit doganor. (sipas modelit të aneksit 2)

8. Një opinion nga dega e tatimeve ku është e regjistruar shoqëria në lidhje me aktivitetin e saj ekonomik.

9. Për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli, autoritetet doganore i kërkojnë administratorit të magazines të instalojë/të vendosë sisteme mbikëqyrëse me video-kamera. Administratori i magazines në këto raste siguron transmetimin dhe ruajtjen e pacenuar të imazheve të regjistruara nga sistemet mbikëqyrëse me video-kamera brenda afateve të përcaktuara nga autoritetet doganore.

Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet në degën doganore e cila do të mbikqyrë këtë rregjim.

Sqarim: Aplikimi për të përfituar regjimin e magazinimit doganor bëhet pranë degës doganore mbikqyrëse.

Autorizimi për regjimin doganor i lëshuar nga autoritetet doganore kompetente përcakton kushtet në të cilat zbatohet regjimi përkatës. Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftojë autoritetet doganore për të gjithë faktorët që lindin pas dhënies së autorizimit dhe që mund të ndikojnë në vazhdimësinë ose në përmbajtjen e tij.

BAZA LIGJORE

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 191 deri 199, 210 deri 215.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 631 deri 648.

REGJIMI I PËRPUNIMIT AKTIV

Çfarë është regjimi i përpunimit aktiv, kuptimi doganor dhe përcaktime të tjera?

Regjimi i përpunimit është një regjim doganor i cili lejon mallrat joshqiptare dhe shqiptare të përdoren në territorin doganor shqiptar, në një ose më shumë operacione përpunimi, të destinuara për t'u riekportuar nga ky territor doganor në formën e produkteve kompensuese, pa iu nënshtruar :

- a) detyrimit të importit;
- b) pagesave të tjera, sipas parashikimeve në dispozitat përkatëse në fuqi;
- c) masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë..

Regjimi i Përpunimit Aktiv ka në thelb eksportimin e punës, teknologjisë dhe faktorëve të tjerë ekonomike që në mënyrë direkte bëjnë transformim të thjeshtë apo përfundimtar në mallra të gatshëm, për t'u përdorur si produkte në operacione të tjera përpunimi, montimi, apo për konsum. Gjithashtu, ky regjim jepet dhe për mallrat e destinuara për t'iu nënshtruar operacioneve që garantojnë përputhjen e tyre me kërkesat teknike për çlirimin e tyre për qarkullim të lirë;

Përdorimi i këtij regjimi doganor ekonomik kushtëzohet nga lëshimi i autorizimit nga autoritetet doganore kompetente.

Dhënia e autorizimit, përcaktohet nga kushtet specifike që e rregullojnë këtë regjim:

- a) I jepet personave që janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) kur personat ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen e operacioneve;
- c) kur autoritetet doganore mund të mbikëqyrin e kontrollojnë regjimin.
- d) kur në rastet e lindjes së një borxh doganor ose detyrime të tjera për mallra të vendosura nën një regjim të posaçëm, ata japin një garanci në përputhje me nenin 84;
- e) autorizimi i lëshohet personave që përdorin mallrat ose marrin përsipër përdorimin e tyre apo personave që kryejnë operacionet e përpunimit mbi mallrat ose marrin përsipër kryerjen e tyre

Procedura për pajisjen me autorizim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave vijon duke depozituar dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë bazuar në Aneksin 8, Shtojca C të Dispozitave Zbatuese
2. Kontratë porosie të shoqërisë me firmat e huaja, për përpunimin e mallrave
3. Deklarim të shoqërisë në lidhje me efektet ekonomike që do të sjellë përdorimi i autorizimit.
4. Në rastet kur importohen mallra të cilat për natyrën e tyre apo procesin teknologjik që

kryhet, humbasin pjesërisht apo tërësisht, paraqitet karta teknologjike dhe metoda që ndiqet për përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit

5. Në rastet kur parashikohet të ketë një ose disa operatorë, paraqitet marrëveshja apo marrëveshjet mes operatorëve dhe kërkuesit të autorizimit si dhe identiteti fiskal i operatorit, deklaratë e operatorit mbi vendndodhjen e ambientit ku do të kryhet përpunimi dhe disponibiliteti i tij për kontroll në çdo kohë nga organi doganor.

6. Rastet kur, kërkohet që zyrat doganore të hyrjes, mbikëqyrjes dhe mbylljes së regjimit të jenë të ndryshme, një deklaram të shoqërisë për argumentimin e saktë ekonomik.

Baza ligjore:

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 191 deri 202, 228 deri 231.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 529 deri 565, 687 deri 690.

Përdorimi i veçantë përfundimtar (end-use)

Nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use), mallrat mund të çlirohen për qarkullim të lirë me përjashtim nga detyrimi ose me një reduktim të nivelit të detyrimit, për shkak të përdorimit të tyre të veçantë.

Mbikëqyrja doganore për regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) përfundon në rastet e mëposhtme:

a) kur mallrat janë përdorur për qëllimet e përcaktuara për aplikimin e përjashtimit ose reduktimit të nivelit të detyrimit;

b) kur mallrat kanë dalë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, janë shkatërruar ose braktisur në favor të shtetit;

c) kur mallrat janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara për aplikimin e përjashtimit ose të reduktimit të nivelit detyrimit dhe për to është paguar detyrimi i importit

Baza ligjore:

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, neni 227.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nen 686.

REGJIMI I LEJIMIT TË PËRKOHSHËM

Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor shqiptar, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar masave të politikave tregtare, të mallrave jo shqiptare të destinuar për t'u riekportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak të përdorimit të tyre.

Autorizimi për lejimin e përkohshëm lëshohet në bazë të kërkesës së personit që i përdor mallrat ose që bën të mundur përdorimin e tyre, pa rënë ndesh me kushtëzimet e mëposhtme:

- a) vetëm për personat që ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen si duhet të operacioneve;
- b) vetëm në rastet kur autoritetet doganore mund të mbikqyrin e kontrollojnë regjimin.

KUJDES!

Autoritetet doganore refuzojnë lëshimin e autorizimit për përdorim të regjimit të lejimit të përkohshëm, në rast se është e pamundur të sigurohet identifikimi i mallrave të importuara, përveç rasteve kur, duke marrë parasysh llojin e mallrave ose natyrën e operacioneve që duhet të kryhen, mungesa e masave të identifikimit nuk sjell si pasojë asnjë formë abuzimi të regjimit në fjalë.

AFATET

Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të riekportohen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor. Ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi.

Afati gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të përkohshëm është 12 muaj, me një maksimum shtyrje deri në 10 vjet, me qëllim që të bëhet i mundur përmbushja e qëllimit të autorizimit.

Regjimi i lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit është një regjim ekonomik që mundëson lehtësimin dhe kryerjen e operacioneve të caktuara, nga subjektet Shqiptare duke përdorur mallrat jo shqiptarë me destinacion riekportimitin e tyre pas realizimit të qëllimit për të cilin ishin autorizuar.

Përdorimi i regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit jepet për mallrat të cilat, ndërsa mbeten në pronësi të një personi të vendosur në një vend të huaj, nuk i plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara për dhënien e regjimit të lejimit

të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit. Afatet janë të përcaktuara në VKM nr. 651, datë 10.11.2017.

Baza ligjore:

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 191 deri 202, 223 deri 226.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 533 deri 534, 649 deri 685.

REGJIMI I PËRPUNIMIT PASIV

Regjimi i përpunimit pasiv lejon që mallrat shqiptare të eksportohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me qëllim që t’u nënshtrohen operacioneve përpunuese dhe produktet që dalin si rezultat i këtyre operacioneve të vendosen në qarkullim të lirë me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit.

Eksportimi i përkohshëm i mallrave shqiptare sjell zbatimin e detyrimeve të eksportit, të masave të politikës tregtare dhe të formaliteteve të tjera për daljen e mallrave shqiptare nga territori doganor shqiptar.

Mallrat shqiptare nuk vendosen në regjimin e përpunimit pasiv kur:

- a) mallrat, eksporti i të cilave çon në rimbursim ose falje të detyrimit të importit;
- b) mallrat, të cilat, para eksportimit, ishin çliruar për qarkullim të lirë me një përjashtim ose reduktim të nivelit të detyrimit për shkak të përdorimit të tyre të veçantë përfundimtar (end-use) dhe nëse qëllimet e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) nuk janë përmbushur, përveçse kur këto mallra duhet t’u nënshtrohen operacioneve të riparimit;
- c) mallra, eksporti i të cilave çon në dhënien e rimbursimeve të eksportit;
- d) mallrat, për të cilat, për shkak të eksportimit të tyre, në kuadër të politikës bujqësore, është dhënë një avantazh financiar i ndryshëm nga rimbursimi i parashikuar në shkronjën “c”, të kësaj pike.

Dhënia e Autorizimit:

Autorizimi për të përdorur regjimin e përpunimit pasiv jepet me kërkesë të personit që krijon mundësitë për kryerjen e operacioneve të përpunimit në një vend jashtë territorit shqiptar.

Autorizimi për të përdorur regjimin e përpunimit pasiv për mallra me origjinë shqiptare, mund t’i jepet një personi tjetër, në rast se operacioni i përpunimit konsiston në përfshirjen e këtyre mallrave brenda mallrave të përfutuara jashtë territorit doganor shqiptar dhe të

importuara si produkte kompensuese, me kusht që përdorimi i regjimit të ndihmojë nxitjen e shitjes së mallrave të eksportit, pa cënuar interesat thelbësore të prodhuesve shqiptare për produkte identike ose të ngjashme me produktet kompensuese të importuara.

Autorizimi jepet vetëm:

- a) për persona të vendosur në Republikën e Shqipërisë;
- b) kur vlerësohet se është e mundur të verifikohet që produktet kompensuese janë përftuar nga përpunimi i mallrave të eksportuara përkohësisht.
- c) kur autorizimi për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv nuk sjell si pasojë cënimin e interesave thelbësore të prodhuesve dhe përpunuesve shqiptarë.

AFATI:

Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit produktet kompensuese duhet të ri-importohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Ato mund ta zgjasin këtë afat me kërkesë të mirë arsyetuar nga ana e mbajtësit të autorizimit.

Baza ligjore:

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 191 deri 202, 232 deri 235.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 529 deri 532, 691 deri 692.

ZONAT E LIRA

Zonat e lira janë pjesë të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose mjedise të vendosura në këtë territor dhe të ndara nga pjesa tjetër e tij, në të cilat hyjnë:

- a) mallrat joshqiptare,
- b) mallrat shqiptare

Këshilli i Ministrave mund të përcaktojë pjesë të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë si zona të lira duke përcaktuar dhe kufijtë gjeografikë të çdo zone të lirë.

Për çdo zonë të lirë Këshilli i Ministrave përcakton planvendosjen dhe pikat e hyrjes e të daljes.

Personat, mallrat dhe mjetet e transportit që hyjnë ose dalin nga zonat e lira janë objekt i kontrolleve doganore.

Paraqitja e mallrave dhe vendosja e tyre në një zonë të lirë

1. Mallrat e futura në një zonë të lirë paraqiten në doganë dhe për to kryhen formalitetet doganore, të parashikuara në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur ato janë futur në zonën e lirë direkt nga jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) kur ato ishin vendosur nën një regjim doganor, i cili ka përfunduar ose është mbyllur me vendosjen e mallrave nën regjimin e zonës së lirë;

c) kur ato janë të vendosura nën regjimin e zonës së lirë për të përfituar nga një vendim që autorizon rimbursimin ose faljen e detyrimit të importit;

ç) kur akte të tjera ligjore, të ndryshme nga legjislacioni doganor, parashikojnë formalitete të tilla.

2. Mallrat e futura në një zonë të lirë, në rrethana të tjera nga ato të mbuluara nga pika 1, nuk paraqiten në doganë.

3. Pa cenuar nenin 219, mallrat e futura në një zonë të lirë konsiderohen të vendosura nën regjimin e zonës së lirë:

a) në momentin e hyrjes së tyre në një zonë të lirë, me përjashtim të rasteve kur ato janë vendosur tashmë nën një regjim tjetër doganor; ose

b) në momentin kur mbyllet një regjim transiti, me përjashtim të rasteve kur ato vendosen menjëherë nën një regjim doganor vijues.

Baza ligjore:

- Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 216 deri 222.